



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 19-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31.05.2023, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Majlinda Sylejmani, anëtare
14. Gentianë Hoxhaj, anëtare
15. Venhar Agushi, anëtar
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragaçina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, kryetar i komunës
2. Diamnt Bytyqi, nënkryetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i komunës
4. Latif Ramadani DBF
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Elmaze Behluli, DA
8. Sead Aliu, DI
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DA
11. Safete Amerrlahu, DGJK
12. Imri Smeteishti, DUMM
13. Burim Rrustemi, DSHPMSH
14. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 19-të e Kuvendit.
2. Propozim Rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.
3. Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e memorialit të Uçk-së në Zonën Katastrale Qylagë.
4. Propozim Vendim për ndryshimin e Vendimit 1Nr.351-668 të datës 13.10.2008.
5. Raporti i Punës së Komitetit për Shendetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për fushë sportive në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.
7. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzimin Afatëgjatë të pronës së paliajtshme të Komunës në zonën kadastrale Grackë e Vjetër (Rishqyrtim).

Pastaj tha se me prepozim të ekzekutivit dhe me rekomanim të KPF-së, janë edhe 2 pika shtesë, të cilat pika kanë qenë edhe heret po për shkak të ndryshimeve në shumën duhet të dalin –prap në Kuvend.

8. Propozim Vendimi për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2022.

9. Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023.

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Arsim Jashari, tha se, unë e kam një vërejtje të procesverbalit që mos të shënohen emrat e drejtorëve të cilët nuk janë prezent në mbledhje.

Me që diskutime tjera nuk pati, kryesuesi e hodhi në votim rendi i ditës i kompletuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 28 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Arsim Jashari, tha se i kam disa kërkesa dhe pyetje për ti ngritur, e para ka të bëjë me 4 familje mbrapa mullirit Bereqeti në Banullë të cilat kanë problem me kanalizim po deri me sot ende nuk kanë marrë asnjë përgjigje, do të ishte mirë që të shkoni ti vizitoni këto familje dhe ta shihni gjendjen në teren. Kërkesa e dytë, ka të bëjë me trotuarin në fshatin Banullë që e kam ngritur edhe më herët dhe e kam shikuar vet aty ka hapësirë në anën e majtë që të bëhet trotuari, do të ishte mirë që të rregullohet ky trotuar. Po ashtu të bëhet rregullimi i trotuarit nga fshati Bujari deri te shkolla në fshatin Llugaxhi. Kërkesa e tretë ka të bëjë me vendosjen e mbrojtëseve të urave të disa fshatra ku çdo ditë qytetarët janë të rrezikuar, e sidomos kur ka reshje të shiut ka një pamje shqetësuese. Kërkesa e katërt edhe nga banorët e fshatit Bujari për trotuar dhe ndriçim deri te shkolla në Llugaxhi. Kërkesa e pestë është për lagjen Magashi nga fshati Llugaxhi ku është pranuar kërkesa po nuk është vazhduar ende puna, kur pritet të filloj puna. Kërkesa e gjashtë lidhet për rrugën “Avdi Kelmendi” ku po ndalen autobusët dhe po shkaktojnë kolona e kjo po i shqetëson qytetarët. Kërkesa e shtatë ka të bëjë me mirëmbajtjen e hapësirave publike nëpër fshatra. I kam edhe dy propozime e para që ta ndërtojmë një shtëpi për persona të moshuar, ndërsa e fundit është një shqetësim i qytetarëve dhe i imi për punësimet partiake për të cilat po behën nga ekzekutivi i komunës. Unë kam një propozim që të punësohen personat adekuat edhe nëse janë partiak.

Ganimete Qeriqi tha se unë sot dua ta ngrise një temë që është aktuale. Trajtohet në të gjitha trajnimet ,ama kuvend s'ju ka kushtuar ndonjë rendësi, krahas projekteve rrugore, ndërtesave e shkallove, rrugëve e te tjera, Neve kuvendareve mos na mbetet pa e ditur rëndësinë e kësaj platforme, tani a doje a nuk doje me përkrah është çështje tjetër. Ideal do te ishte kjo platformë me u zbatuar me përpikëri. Vendi ynë Kosova ka kornizat ligjore dhe politike qe i trajton barabartë: burrat ,gratë ,djemtë vajzat në të gjitha sferat: ekonomike ,sociale ,politike, arsimor etj...por ka edhe një instrument te rëndësishëm si ne nivel qendror edhe komunal: Buxhetimin e Përgjegjshëm gjinor, çka synon kjo platformë neve anëtareve te kuvendit nuk bën me kaluar pa e ditur. Është platforme qe ulë pabarazinë mes gjinive dhe avancon barazi dhe barabarësi ne mes burrave grave , djemve vajzave ; Varësisht nga nevojat e tyre të ndryshueshme. Komunitat e kanë obligim ligjor çdo vit ta hartojnë buxhetin vjetor. Në ato fonde publike duhet te kenë qasje dhe te përfitojnë barabartë burrat ,gratë ,djemtë ,vajzat, varësisht nga nevojat qe i kanë. Është obligim i komunës me dhanë grafika, shabllonë, e me qenë transparente për përqindjen e barazisë gjinore te komunës sa % ka shkuar te gratë e sa % ka shkuar te burrat. Nëse Komuna nuk e zbaton Barazinë gjinore ka shkaktuar dhune ekonomike ketë rast duhet me u rrite pjesëmarrja e grave në dëgjime publike, konsultime në investime kapitale Nëse komuna ka ngecje në ndarje të BPGj dhe në analize gjinore ka obligim me kontraktuar ekspert ligjor e me bërë analizën gjinore

Daut Azemi kryesuesi i Kuvendit tha se kërkoj nga anëtarët e Kuvendit që ta respektoni rregullorën e punës së kuvendit dhe të bëni pyetje por jo edhe diskutime pasi që po stërzgjatët mbledhja.

Lumturie Bytyqi tash më kemi hytë ne sezonin e verës dhe përdorimi i trotineteve elektrik është mjaft shqetësues për qytetarët e komunës së Lipjanit ky shqetësim është ngritur edhe me herët në kuvend dhe është mire që trotinetët dhe motorët elektrik të ndalohen në shesh.

Egzona Bytyqi tha se unë kam tri çështje për të ngritur një çështje ku ka të bëjë me shkollën fillore "Haredin Bajrami" në fshatin Magurë ku ka një numër të madhe të nxënësve edhe pse higjiena është ne nivel por do të ishte mire që të kenë një makinë lëvizëse për pastrimin e dyshemesë. E dyta ka të beje me qendrën e azilantëve në Magure a ka ndonjë rregullore pse i ka mbet barra vetëm komunës së Lipjanit që të kujdesen për shërbimet shëndetësore në atë qendër. E treta kam një apelim për qytetarët që mos t'i përdorin armët gjatë dasmave.

Ardit Cani tha se kam për të ngritur disa kërkesa të cilat i kam ngritur edhe më herët e që ka të bëjë me rregullimin e trotuarit në fshatin Baincë dhe Resinofc, ku kërkoj që të ju bëhet një zgjidhje këtyre banorëve. Çështja tjetër ka të bëjë me mirëmbajtjen e hapësirave publike në fshatra por edhe të burimi i ujit të nxehtë në Baincë, dhe kërkesa e tretë ka të bëjë me kanalizimin e bllokuar në fshatrat Risinovc dhe Shalë.

Herolind Kozhani tha se kam një kërkesë për fshatin Ribar i Madh për fushën e futbollit ku propozoj që të vendoset një tepi prej gome për arsyeje të rrezikshmërisë për shkak që po mbahet një nder turnirët më të mëdha në Komunën e Lipjanit por edhe në tërë Kosovën.

Lulzim Rustemi, tha se kam një pyetje lidhur me ndërtimin e shtegut të ecjes në Gadime të Epërme deri ku ka shkuar ai projekt, pasi që aty punët janë duke u bërë shumë keq dhe ka pa përgjegjësi nga ana e operatorit. Është mirë me mbikëqyr se si po kryehut puna aty. E dyta kam një propozim konkret, që DPUMM që ti shtjelloj proceduar për park nacional në Gadime, në atë pjesë të shtegu i ecjes, pasi që është një pasuri e madhe. E treta, ene mëditjen asnjë komisioni ende nuk i kemi marr dhe doni me na shty që ne me i bojkotuar punën e komisioneve.

Albiona Tasholli, tha se kam një shqetësim për ta ngritur për shportat e mbeturinave ku janë dëmtuar të shtegu i ecjes në Gadime nga persona të pandërgjegjshëm edhe pse aty është bërë një punë e mirë nga ekzekutivi. Po ashtu kërkoj që të bëhet vendosja e shportave të reja të shtegu i ecjes në Gadime.

Kam disa pyetje për drejtorin e DKA-së cilat janë politikat dhe udhëzimet që të ndalohen sjelljet negative të nxënësve nëpër shkolla, çfarë trajnime janë duke u kryer për profesor. Kur pritët të përfundoj trotuari në rrugën Gadime –Llugaxhi.

Bashkim Budakova, tha se e kam një pyetje për ekzekutivin për një projekt i filluar në vitin 2019 për mirëmbajtjen e lapidarëve a është duke u implementuar pasi që gjendja faktike flet ndryshe.

Fitim Mziu, tha se dua të ngrisë një shqetësim për udhëkryqin në veri të Lipjanit ku shpejtësia e vozitjes së automjeteve është e madhe dhe po ka aksidente të mëdha. Do të ishte e mirë që të ketë aty një patrullë të policisë. Pyetja e dytë ka të bëjë me sëmundjen e tuberkulozit e cila është një sëmundje e shërueshme, a ka ndonjë strategji për pengimin e përhapjes së kësaj sëmundje?

Shahadije Dragaçina, tha se banorët e rrugës ‘Ganimete Tërbeshi’ po kërkojnë asfaltimin e rrugës dhe ndriçimin publik në pjesën e tyre. A është në plan të asfaltohet kjo rrugë. Po ashtu pyetja e dytë ka të bëjë me ndërtimin e rrugës atë shkollën e fshatit Janjevë. Dhe pyetja e fundit ka të bëjë me DKA-në a janë ndarë mjete për nxënësit e shkollës “Vllëzrit Frashëri” për robotikën për në Amerikë?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se ata të cilët nuk e kanë votuar buxhetin për vitin 2023 nuk kanë të drejtë të pyesin, E tash pyesin pse nuk kryhen ato projekte ata nuk kanë të drejtë as të pyesin fjalën e kam për ata që nuk e kanë votuar. Sa i përket rrugicave thuaj se janë kryer në të gjitha fshatrat por do të përfundohen së shpejti edhe aty ku kanë mbetur. Fshati Llugaxhi është në proces për asfaltimin e rrugëve. Hapësirat publike po mirëmbahen nga ana e komunës po ashtu edhe mirëmbajtja e lapidareve dhe varëseve, po ashtu kemi edhe një kontratë për mirëmbajtjen e lumenjve. Ideja për një shtëpi të moshuarve është me vend por nuk e di a do të kemi mundësi buxhetore. Sa i përket dukurive negative nëpër shkolla është problem në nivel vendi por Lipjani nuk mendoj që është në gjendje të keqe. Urat do të mundohemi të i përfundojmë gjatë mandatit në vazhdim aty ku e shohim më të nevojshëm. Siç jemi duke bërë ndërtimin e urës të lumi Sitnica të rruga “Marie Shllaku”. Tek trotinetët dhe motoçiklistët elektrik është shumë e drejtë duhet ta nxjerrim një vendim më të cilin kufizohet lëvizja e tyre. Sa i përket mirëmbajtjes së shkollave ne kemi dërguar aty sa kemi pas mundësi por a jemi të kënaqur nuk jemi, por ministria s’po na ndihmon si komunë. Për qendrën e azilit nuk jam në dijeni. Sa i përket kërkesave për trotuar dhe ndriçim në Bainsë dhe Risinovc ke të drejtë, por do ta shohim në mundësitë buxhetore. Gjatë punimeve në teren mund të ketë disa defekte por ato përmirësohen. Ne jemi duke bërë identifikimin pronave publike, po ashtu dhe të pronat private aty ku na duhet për të mirën e qytetarëve edhe do të shpronësojmë. Te pagesat do të procedojmë tani do të bëhen përmes listës së pagave. Trotuari i Gadimes do të fillojë shpejtë. I kam mbështet nxënësit kudo që kanë shkuar çdo vit dhe do t’i mbështes çdo herë.

Alban Saliu, tha se, së pari nëse dikush nuk e voton buxhetin nuk e ndalon që ti ngris problematikat e qytetareve, pasi që ne i përfaqësojmë qytetarët dhe do të vazhdojmë ti ngrisim, kërkesat dhe preokupimet e tyre. Çështja e parë që do ta ngris ka të bëjë me disa persona që dalin të mbledhin mjete nga qytetarët, a janë interesuar organet gjegjëse për këtë fenomen, duhet të shihet kauza për këto mjete si po ndahen, nuk dua të paragjykoj, por nuk është që në Kosovë nuk është përfituar kur ka pas raste të tilla. Çështja e dytë ka të bëjë me vizitën e nxënësve të shkollës së mesme në Shqipëri, ku nëse jeni takuar me nxënësit e këtyre shkollave tregojnë që kushtet nuk

kanë qenë aspak të mira. Nxënësit kanë bërë pagesa dhe është e pa drejt që te trajtohen në këtë mënyrë, a është e interesuar DKA për këtë situatë, si është e mundur që çdo vit përsëriten të njëjtat ankesa dhe drejtoria e Arsimit nuk merr asnjë masë, kjo vlen me kuptua që kjo drejtori është e përfshirë në keqpërdorime. Çështja e tjetër ka të bëjë me furnizimin me drunjtë në shkollat e komunës së Lipjanit, ka informata që furnizimi me drunjtë për djegie në shkollat e komunës së Lipjanit po shoqërohet me keqpërdorime të shumta, furnizimi dhe çka faturohet është në shpërputhje të madhe, ka pasur raste kur drejtor të shkollave të caktume kanë refuzuar të nënshkruajnë faturën pa u bërë matja e këtyre druve, por furnizuesi ka refuzuar kategorikisht, me ç'rast ka shkuar drejtori i arsimit i cili ka kërkuar nga drejtorët e shkollave që ta nënshkruajnë faturën e mos ta zgjasin shumë. Nga këtu ju bëj thirrje organeve të drejtësisë që te reagojnë ndaj këtyre rasteve dhe ju them që jam i gatshëm për bashkëpunim. Dhe e fundit në tetor të vitin 2021, kryetari na pat ftuar që të shkojmë ti vizitojmë ndeshjet bashkë në stadiumet në Dobrajë dhe Magure ,pasi që në tetor do te jenë në funksion, na tash po e vizitojmë por aty nuk po shohim futboll por po shohim shirita të krimeve ekonomike. Në atë Kohë KF Arbëria bënte gara në super ligë ndërsa tani ka rënë edhe nga liga e parë. kjo është gjendja në këtë klub sot.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës, tha se fushat e sportit do te shtohen me gomë por për shkak te shiut nuk po mund te fillojmë. Ashtu siç kam deklaruar prape do te deklaroj, që do te vini ti shikoni ndeshjet, ashtu siç jeni duke i ndjekur sot në fushat e vogla. Sa i përket atyre që kërkojnë ndihma me siguri kërkojnë për ata që kanë nevojë dhe aksionet e tyre janë vlerë e madhe e kësaj shoqërie. Sa i përket drunjtëve , i ke organet e rendit dhe merru me këtë punë. Unë i kam ndërtuar dhe do ti ndërtoj shumë stadione dhe fusha në te mirën e qytetareve të komunës së Lipjanit.

Rasim Hasnai, tha ato që i tha Albani sot ka me i dëshmuar.

Besiana Syla, tha se do ta ngrit një çështje të cilën e kam ngritur edhe më herët që ka të bëjë me rrjetin e kanalizimit të 40 shtëpive. Ky problem është shumë vjeçar ku banoret janë detyruar të largohen nga shtëpia sepse kundërmon erë e keqe. Çka do të ndërmerr komuna e Lipjanit për zgjedhjen e këtij problemi.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se e keni ministrin Meha i cili vinte në fushat tek ato familje dhe ai le të ju bëjë zgjidhje.

Besjana Syla, tha se unë kam ngritur këtë çështje të kanalizimit dhe ky është problem i komunës së Lipjanit,

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se nëse i keni procesverbalet dhe e shiheni qe ju nuk e keni votuar për atë vendimin për buxhet dhe me këtë nuk mund ta mashtroni askënd.

Rinor Murati, tha se kemi një kërkesë për transportin e fëmijëve të lagjes së Akllapit që ta siguroj të paktën nga viti i ardhshëm. Pasi që nga Lipjani ka nxënës që vijnë në mesimet në shkollën e mesme në qytetet tjera si në Prishtinë dhe Ferizaj andaj kish me qen më mire të kemi një paralele në qytetin tonë të Lipjanit.

Armend Grajqevci, tha se së pari ia uroj kryetarit të komunës vendin e dytë për transparencë. Po ashtu tha që edhe unë pajtona me parafolësit që të ndalohen trotinetet dhe motorët elektrik në sheshin e Lipjanit, po ashtu dëmtimi i pronave publike që po dëmtohen nga persona të pa ndërgjegjshëm. Po ashtu kam një shqetësim për rrugën Lipjan QMI, e cila është në gjendje shumë të keqe, kërkoj nga drejtori i infrastrukturës që të bëjë një kërkesë prapë në ministri që kjo rrugë të asfaltohet..

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, bartjen e nxënësve në shkollë do ta shohim, rruga prej QMI është e projektum në ministri po nuk po shtohet nga ana e qeverisë.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 18-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 18 e Kuvendit , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 27 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 17-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Propozim Rregullore për transportin e udhëtarëve me automjete taksi.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemit, drejtor i DSHPMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Fadil Spahiu, tha se propozoj që të bëhet një ndryshim neni 5 par 1.7 ku thuhet se operatorët që operojnë me autotaksi në qytetin e Lipjanit duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se viti 2005 ndërsa operatorët të cilët operojnë në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” duhet të kenë automjetin me vitin e prodhimit jo më të vjetër se 2010. Po ashtu propozoj që te vjetërsia e automjeteve të caktohet me vite, psh. Operatorë që operojnë në Lipjan, automjeti nuk duhet të jetë më i vjetër se 18 vite respektivisht 13 vite operatorët që operojnë në Aeroport. Sepse Rregullorja nuk ndryshohet çdo vit dhe ndonjë operator mund të aplikoj për Licencim pas 3 apo 4 viteve dhe të thirret në rregullore me mundësin e vitit të prodhimit të automjetit 2005 respektivisht 2010. Me që jemi duke e miratuar këtë Rregullore po e ngris edhe një çështje tjetër lidhur me caktimin dhe dhënien në shfrytëzim të vend parkingjeve për auto taksi. Auto taksit që e kanë në shfrytëzim vend parkingun në parkingun e madh, gjithmonë po e shfrytëzojnë rrugën e hyrjes për në parking si vend parking dhe me këtë veprim po vështirësohet hyrje-dalja në parking. Nuk e di a nuk është e mjaftueshme hapësira e caktuar për vend parking apo po ju bllokohet vend parkingun nga qytetarët, apo ku qëndron problem.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha parimisht ne si grup i PDK-se, e përkrahim këtë rregullore por parimisht një kërkesa që inspektorati të inspektoj aerotaksitë se a i plotësojnë kushtet sipas rregullores pasi që në praktik nuk është që taksit e kanë që nuk e kanë respektua këtë rregullore. Po ashtu pajtohem me parafolësin që neni 5 të jetë vite e jo nga viti pasi që vitet kalojnë dhe stervjetrohet vetura. Duhet të jetë e specifikuar në 13 dhe 18 vite.

Armend Grajqevci tha se ne si grup i LDK-së e përkrahim dhe e mbështesim këtë propozim rregullore.

Bashkim Budakova, tha se dua një sqarim te neni 12-të te kushtet ku ceket që automjetet taksi të vendoset një shirit identifikues bardh e zi në formë katrore. A është

e domosdoshme vendosja e shiritit me ngjyrë bardh e zi apo mundet të ketë edhe ndonjë ngjyrë tjetër.

Burim Rustemi, tha se ideja se ngjyra e këtij shiriti është që të identifikohet më lehtë nga qytetarët. Pajtohem me propozimet e parafolësve.

Daut Azemi kryesues i kuvendit tha se nëse e ndryshojnë këtë nën mos po ua vështirësojmë punën taksistëve për licencim.

Arsim Jashari, tha se autotaksit duhet të kenë vetura sa me te mira ne mënyre që qytetarët të jeni të sigurt dhe kjo rregullore ka bazë të mirë

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit, me propozimin e kuvendit që të ndryshohet në 13 vite dhe 18 vite dhe jo të jetë, viti 2005, dhe 2010 dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, aprovoi Vendimin.

III

Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e memorialit të UÇK-së në Zonën Katastrale Qylagë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi, drejtoreshë e DKRS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Rinor Murati, tha se ne grupi i LDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

Egzona Bytyqi, tha se ne si grup e kemi analizuar këtë propozim vendim dhe e përkrahim ne mënyrë unanime. Po do te ishte mire sikur kjo kërkesë te vinte nga OVL-UÇK në Lipjan.

Fadil Spahiu, tha se ky Propozim Vendimi për ndarjen e një pjese të pronës komunale në Zonën Kadastrale Qylagë ka ardhur si rrjedhojë e kërkesës së Këshillit organizativ për realizimin e projektit Memoriali Istikamet e UÇK-së dhe se qëllimi për ndërtimin e memorialit përkujtimor është respekt për veteranët dhe nderim për të rënë të luftës së lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, unë e mbështes në tërësi këtë Propozim Vendim dhe shpresoj që ky projekt të mos mbetet vetëm në letër, por në të ardhmen e afërt ta mbështesim edhe financiarisht realizimin e këtij projekti.

Lulzim Rrustemi, tha se ne e mbështesim propozim vendimin pasi që është vlerë e madhe për ne. Por kam vërejte për propozimet që vinë për zonat katastrale që të jenë me projektorë në mënyre që ne si anëtar të kuvendit ta shohim se ku është saktë ajo pronë.

Anila Reqica Llugiqi tha se i falënderoj parafolësit që me mbështetën këtë propozim vendim dhe ju njoftoj që grupi ka qenë ne emër të organizatave të dalur nga lufta.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi Vendimin.

IV

Propozim Vendim për ndryshimin e Vendimit 1Nr.351-668 të datës 13.10.2008.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemit, ia kaloi fjalën Imri Semetishtit, drejtor i DPUMMi cili i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata?

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është një gabim teknik te renditja e neneve të vendimit i cili duhet të përmirësohet.

Fadil Spahiu, tha se parcelat nga pika me numër rendor 1, 2, dhe 3 të Vendimit 1Nr.351-668 të datë 13.08.2008 kanë qenë në menaxhim të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe janë privatizuar dhe kanë kaluar në pronësi private si dhe parcela e pikës me numër rendor 4 e po të njëjtit Vendim është në menaxhim të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë – Departamenti i Rrugëve. Nuk kemi çka diskutojmë sepse ato parcela tashmë janë të dikujt tjetër. Ndërsa për parcelën 00007-0 me sipërfaqe 21715 metra katror, Zona Kadastrale Grackë e Vjetër në pronësi të Komunë së Lipjanit e evidentuar në pikën me numrin rendor 5-të të njëjtit Vendim, mendoj se për fazën e parë është hapësirë e mjaftueshme që të shpallet interesi i përgjithshëm për ndërtimin e objekteve banesore për kategoritë e dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit. I bëj thirrje ekzekutivit që të gjej ndonjë investitor sa më parë që mundet, që të bëhet zgjidhja e çështjes së banimit të kategorive të dalura nga lufta e UÇK-së nga Komuna e Lipjanit.

Lumturie Bytyqi-Hasani, tha pse është dashtë me pritë 15 vite që veteraneve me ju realizua një e drejtë që do të ua zgjidhte çështjen e banimit, pse kemi prit gjithë këto vite. Dhe a e keni seriozisht këtë punë, pasi shumë veteran janë tu e pritë këtë vendim.

Imri Semetishti, tha se është pritë kaq shumë vite për shumë arsye se pari nga viti 2018 kanë qenë kërkesat të lidhura me AKP-në me transferin e pronësisë, privatizimi ka ndodh me herët por të dhënat në shërbimin katastral janë krye në vitin 2015. Pra regjistrimi i pronave ka fillua në vitin 2015. E kemi shumë seriozisht këtë punë edhe pse ka me qenë një sfidë në veti.

Shahadije Bikliqi, tha se pasi që do të kaloj ky propozim vendim, a ka ndonjë plan konkret për ndërtimin e këtyre banesave për këto kategori.

Lulzim Rrustemi, tha se ky propozim është diskutuar sa kam qenë unë kryesues i kuvendit, është një pronë e mirë ka hapësire të mjaftueshme, por nuk ka pas vullnet politik. Është mirë që po e merr formën në të mirë të qytetarëve.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi Vendim

IV

Raporti i Punës së Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Nexhmedin Lekiqit kryesuei i Komitetit për Shëndetësi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ganimete Qeriqi, tha se edhe ne shëndetësi çdo lider që merr pushtetin e ka obligim shëndetin e popullatës sikurse infrastrukturën. Sa i përket neve anëtareve të komisionit kemi bërë përpjekje ,kemi dhënë sugjerime për tejkalimin e disa sfidave .tash para jush keni raportin e punës tone. Falënderojmë edhe drejtorin që ka qenë prezent në mbledhjet tona dhe nja ka marrë sugjerimet e tona. Uroje që tash e tutje të bëjmë hapa para dhe të kemi shërbime ma cilësorë.

Fitim Mëziu, tha se komiteti për shëndetësi është këshillëdhënës për drejtoratin e shëndetësisë, më qellim të përmasimit të shërbimeve shëndetësore për të mirën e qytetarëve. Në raport janë përfshirë disa punë të mira të cilat bëhen në shëndetësi. Ne

në vazhdimësi kemi dhënë rekomandimet dhe vërejtjet tona për të mirën e shëndetësisë. Por si shihet në shëndetësi nuk ka një organizim të mirë, por duhet punuar për tu ndryshuar. Unë jam i gatshëm që të bashkëpunoj për të mirën e shëndetësisë në komunën e Lipjanit.

Alban Salihu, kur u lexua raporti i shëndetësisë, po te isha me një vend tjetër shërbimet shëndetësore do t'i i kryeja në Lipjan. Raporti është në përputhje me gjendjen reale me të cilën përballlet shëndetësia në Lipjan. Unë e falënderoj anëtarët e komitetit për punën që po e bëjnë por ne qetë mënyrë nuk i ndihmohet shëndetësisë. Unë e vizitoj shëndetësisë shpesh, por realiteti është ndryshe nga raporti. Do të ishte mirë që të kishte edhe kritika dhe rekomandime nga komisioni.

Nexhmedin Lekiqi, tha se ne si komitet e kemi bërë këtë raport duke bërë vizita në QKMF-QMF,AMF, dhe e kemi parë që gjendja në shëndetësi është përmirësuar por kemi dhënë edhe disa rekomandime te cilat i kemi pa gjatë vizitave në teren e të cilat i kemi marr për së afërmi duke biseduar me stafin e shëndetësisë, por edhe duke i parë edhe kushtet e tyre të punës.

Shahdije Dragaçina, tha se unë i kam pyetje, ku thuhet se ne raport janë bërë investime në QMF në Gadime, ndërsa ne një vend tjetër thuhet që janë duke u bërë investime pra këtu ka mospërputhje ne mes të raporteve. Po ashtu keni cek se në QMF në Magure, problem mbeten azilantët por nuk e keni cek se çfarë probleme?

Egzona Bytyqi, tha se e vlerësoj shumë këtë raport pasi që ne këtë raport këta tregojnë se kanë bërë vizita në teren dhe kanë parë për së afërmi gjendjen ne teren dhe kanë dal me disa rekomandime me qëllim që të rritet cilësia e shërbimeve shëndetësore. Por edhe ne si grup përmes anëtares tonë në komitet kemi dhënë kontributin tonë. Një rekomandim i imi është që preventives me i kushtua rëndësi po dhe me vazhdua bashkëpunimin me AQH dhe me rrit bashkëpunimin me organizata tjera..

Fadil Spahiu, tha se duke u bazuar në këtë raport është evidente se është bërë një punë e mirë e të gjithë anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për këtë Raport të detajuar ku janë përfshirë të gjitha vizitat dhe aktivitetet e anëtarëve të Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, të cilët i përgëzoj për këtë raport. I përgëzoj sepse nëpërmjet monitorimit gjatë vizitave në teren për gjatë periudhës kohore që nga themelimi i Komitetit e deri me 15 Maj 2023 është bërë një vlerësim i gjendjes faktike me anë të së cilit janë dhënë disa rekomandime por edhe është konstatuar se në kohët e fundit ka të arritura në shumë çështje dhe janë në nivelin

e duhur, siç është gatishmëria profesionale e stafit për ofrimin e shërbimeve mjekësore dhe pajisja me aparaturë moderne dhe funksionimi i tyre në QKMF dhe QMF. Pavarësisht se sa të zgjeroheni me raport është e vështirë të përmbledhin dhe të futen në raport të gjitha mangësitë dhe të arriturat. Andaj kam dy pyetje lidhur me pajisjet dhe ofrimin e shërbimeve në QKMF: kam disa pyetje? Pyetja e parë: A është pajisur QKMF-ja me Laborator për analizën e CRP, e bëra këtë pyetje sepse kjo aparatura është shumë e nevojshme që qytetarëve tu afrohet ky shërbim dhe se para disa kohe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale ka premtuar se shumë shpejt do të pajiset QKMF-ja me këtë aparaturë. Pyetja e dytë: para pak kohe ka përfunduar Renovimi i QKMF-së, para dhe gjatë renovimit ka pasur shumë kërkesa nga qytetarët që të ngritet numri i dhomave respektivisht shtretërve për shërbimin me infuzion, sepse për shërbimin me infuzione qytetarët në shumicën e rasteve duhet të presin në radhë për arsyeje të mungesës së hapësirës. A është plotësuar kjo kërkesë!

Fitim Mëziu, tha se raporti përmend disa gjëra të mira dhe është kesh dhënës për drejtorinë. Problemi të shëndetësia problemi është se aty nuk ekziston menaxhimi si duhet pasi që ka mangësi të mëdha në menaxhim. Ne kemi problem edhe në Gjinekologji pasi që aty nuk kemi mjek, po ashtu edhe në Emergjencë pasi që aty kemi mjek të mirë por nuk kanë përvojën të mjaftueshme, po ashtu mungesë të mjekëve familjar dhe të përgjithshëm në disa vende.

Lulzim Rrustemi, tha se komiteti ka bërë një punë të mirë dhe duhet me e përshëndet. E dyta ka dalë në teren dhe i ka parë gjendjen në QKMF dhe QMF. E treta kanë dalë me disa rekomandime ku i kanë cek edhe disa sfida, e të cilat nëse punojmë për përmirësimin e tyre mund të ecim përpara. Duhet të përmirësohen disa shërbime të emergjencës, gjinekologjia por edhe në disa dikastere të tjera e të cilat komiteti i ka përfshirë. Është dashtë që të përfshihet nga ky komiteti dhe nataliteti, po ashtu nuk janë përfshi edhe çështjet sociale të cilat janë shumë të ndishme.

Lumturie Bytyqi-Hasani, një raport që është bërë gjatë 6 mbledhjeve të komitetit, do të ishte mirë që në të ardhmen me u marrë me të drejtat e punëtorëve që shkelen shpeshherë, ku nuk ka shujtë ditore, nuk ore të kujdestarisë e të tjera. Dhe kam një pyetje për kryesuesin e kuvendit pse nuk ka ardhë në Kuvend raporti i Komiteti për Komunitete.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se, nuk kam dashtë shumë me ngarkua kuvendit me pika, por do të vijmë në kuvend edhe raportet e komiteteve tjera.

Shkelzen Hajdini, tha se e falënderoj komitetin për punën dhe bashkëpunimin që kemi pas dhe neve na ndihmon që në të ardhmën edhe me shumë që të punojmë për të mirën e shëndetësisë. Në komunën e Lipjanit ofrohen afër gjysmë milion shërbime për qytetarët. Dhe ne si shëndetësi po dalim ne mesin e komunave me të mira. Te kujdesi i paliativit ne jemi mire, po ka hapësirë për punë. Te urgjenca ka disa vërejtje por nuk janë me vend , pasi qe aty janë bërë punë të mira dhe po vazhdojmë të punojmë. Fotografimi punon dhe te gjitha analizat ne QKMF.

Arsim Jashari, tha e kam një propozim që të bëhet si ne vendet e Evropës ku ipen disa karton me ngjyra, dhe ne bazë të ngjyrës që e ke të bien me krye shërbimin.

Fadil Spahiu, unë kam qenë vet të bejë analizën e CPR-së, por stafi shëndetësor me kanë thënë qe nuk punon.

Shkelzen Hajdini,nuk ka bërë disa ditë për shkak qe është dashtë të bëhet kalibrimi.

Nexhmedin Lekiqi, tha se unë kam ardh nga kurbeti e kam pa që shëndetësia ka qenë në gjendje jo të mirë ndërsa tani është përmirësuar dhe janë duke u bërë punë të mira në shëndetësi.

Pastaj Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit dha pauzë deri në ora 12:30 deri në, 14:00

Pastaj u kalua ne pikën në vijim.

V

Propozim Vendimi për caktimin e lokacionit për fushë sportive në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica-Llugiqi, drejtoreshë e DKR-së e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Nexhmedin Lekiqi, tha se unë e përkrahu këtë propozim për ndërtimin e stadiumit, por kam vërejtjet e mija pasi që nuk po bëhen analiza të mira pasi që lokacioni në fjalë është i papërshtatshëm pasi që aty afër janë gurthyesit dhe bëhet pluhur e zhurmë nga ata gurthyes.

Arsim Jashari, tha se çka do qe vjen në emër të sportit ne e përkrahim si grup dhe do ta ketë mbështetjen tonë si grup i PDK-së.

Fadil Spahiu, tha se sa i përket propozim vendimit për caktimin e lokacionit për fushë sportive në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve në pjesën e parcelës 555-4 me sipërfaqe prej 25000 metra katror nga sipërfaqja e përgjithshme prej 67185 metra katror, me që qëllimi i këtij propozim vendimi është që në këtë parcela të ndërtohet një stadium i futbollit ku qytetarët dhe sportistët e fshatrave të kësaj zone do të kenë mundësinë e zhvillimit të aktiviteteve sportive dhe të rekreacionit. Unë mendoj se përzgjedhja e këtij lokacioni është shumë e qëlluar duke u bazuar në pozitën gjeografike të kësaj parcele që gjendet në mesin e disa fshatërave dhe gjendja e tanishme e kësaj parcele që është pothuajse deponi e mbeturinave të shndërrohet në arenë sportive dhe rekreacioni është vërtetë një mrekulli. E mbështes në tërësi këtë Propozim Vendim.

Albiona Tasholli, tha se ne si grup i LDK-së e mbështesin këtë Propozim Vendim për caktimin e lokacionit për fushë sportive në zonën kadastrale Babush i Muhaxherëve pasi që e shohim që është shumë i nevojshëm dhe i mirëpritur nga banorët e kësaj ane. Ku djem dhe vajzat tona mund të shkëlqejnë.

Arsim Jashari, tha se është një klub i futbollit në Gadime, dhe do të ishte e mirë që ky stadium të bëhet për atë pjesë dhe për atë klub.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha se, unë vi prej asaj pjese, ajo që e tha dr. Nexhi, është reale pasi që nuk është edhe vend aq i përshtatshëm për shkak të gurthyeshve por si do që të jetë ka qenë kërkesë e klubit të Gadimes. Ne po e ndajmë vetëm lokacionin.

Lulzim Rrustemi, a ka pas propozime për lokacione tjera, pasi që është i diskutueshëm si lokacion.

Anila Reqica-Llugiqi, tha se kërkesa nga KF Gadimja ka qenë për këtë lokacion.

Daut Azemi, tha se nuk është edhe shumë i përshtatshëm për banorët e atyre pjesëve por nuk ka një lokacion tjetër më të përshtatshëm që i plotëson kriteret dhe kërkesa e klubit atë qenë për atë lokacion.

Alban Salihu, tha se shpresojmë që këta ekspertet nuk janë te njëjtë me stadiumin në stadiumet tjera pasi që tani po rrëshet dheu.

Daut Azemi, kryesuesi i kuvendit tha, se në atë pjesë nuk rrëshqet dheu pasi që aty është kodër është vend guror.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 29 vota për, aprovoi Rregulloren.

VI

7. Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzimin Afatëgjatë të pronës së paliajtshme të Komunës në zonën katastrale Grackë e Vjetër (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Burim Rrustemi, drejtor i SHPMSh-së, i cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Vendimi.

Fadil Spahiu, tha se propozoj që ky Propozim të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe të kërkohet nga Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" që ta bëjë precizimin e kërkesës, sepse Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" nuk është pjesë e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimesh është në kundërshtim me Nenin 21 par 1.1 të Ligjit Nr 06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës dhe Nenit 24 të Rregullores Nr.09/2020 të cilëve i'u ka referuar. Andaj, Kopanis Rajonale të Mbeturinave "Pastrimi" i sugjeroj që për të ju shmangur Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës të thirret në Nenin 26 par 1, 2 dhe 2.1 të Rregullorës Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës. Si dhe Nenit 3 par 3.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike. Meqë dhashë Propozim dhe Sugjerim nëse e shihni të arsyeshme i lexoj këto dy nene. Në Rregulloren Nr.09/2020 në Nenin 26 par 1. Thuhet, Komuna ka të drejtë të jep pronën në shfrytëzim, për institucionet e sajë vartëse apo të bëj destinonim e pronës për nevojat e sajë, pa i zhvilluar procedurat e përcaktuara me ligjin përkatës për dhënë në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës komunale. Paragrafi 2. Institucionet vartëse për të cilat komuna nuk zhvillon procedurën e përcaktuar për dhënien e pronës komunale, janë: Paragrafi 2.1. Ndërmarrjet publike Lokale, sipas Ligjit përkatës për ndërmarrjet publike. Ndërsa në Ligjin Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike në Nenin 3 par 3.2. thuhet - Të gjitha ndërmarrjet e radhitura në Listën 2, e cila i është bashkangjitur këtij ligji është Ndërmarrje Publike Lokale. Të gjitha Ndërmarrjet Publike Lokale janë në pronësi të komunës ose komunave të përcaktuara në Listën 2, dhe përqindja e pronësisë së secilës komunë do të jetë siç është përcaktuar në Listën 2.

Shahadije Bikliqi, tha se unë e kam një vërejtje të përgjithshme, për vendimet të cilat po na kthehen për shkak të mos përputhjes ligjore, ku për neve është shqetësuese dhe qesharakë. Kjo është shqetësuese për neve.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është normale me ndodh për këtë janë disa organe me i mbikëqyr disa organe tjera, edhe juve plot vendime po ju kthen Gjykata kushtetuese

Lulzim Rrustemi, tha se prap ky vendim nuk është në përputhje me ligjin, ata janë kap me një nenë, por prape ata do ta kthejnë pasi që ka shkelje ligjore, Pasi që komune nuk mundet një institucioni me i dhënë pronë me procedura të veçanta, ku neni 6 i ligjit dhe neni 24 i rregullores nuk e lejon me dhënë me proceduara të veçanta. Ne si grup nuk e votojmë. Pasi që komuna duhet me ankand publik me shpall. Dhe nuk mund të ipet prona pa u planifikua ne listën ku edhe kjo është në kundërshtim me ligjin.

Arsim Jashari, a kish qenë mirë me pritë me bë një kompani tonën dhe me dislokuar në një vend më të mirë, ne keni vullnetin ju si asamble e shtyjme këtë vendim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, do të ishte mirë që kjo pikë të shtyhet pasi që kthimin i këtyre vendimeve te paligjshme e dëmton përfomancën e komunës.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se nuk mund te shtyhet kjo pikë pasi që duhet brenda afatit 30 ditor kjo që të rishqyrtohet në Kuvend. Ministria e ka dhënë vërejtjen për çka është rikthyer.

Nexhemdin Lekiqi, tha se mendoj që ky vendim duhet të shkoj sa me shpejtë pasi që nuk shkon sot shumë shpejt mund te bëhet edhe një deponi tjetër e mbeturinave apo një gurthyes ne atë vend.

Arsim Jashari, tha se ata e kanë goditë vetëm aty te titullari, ligjërish nuk mundem me ja dhënë. Ata prape kanë me kthye.

Daut Azemi, tha ne si kuvend mund te ja marrim pronën momentin që e kemi kompaninë tonë komunale.

Burim Rrustemi, tha se neve na është kthyer me arsyetimin për shkak te kërkesës që duhet të vijë nga titullari.

Fadil Spahiu, titullar nuk mund me qenë kompania Pastrimi, por një institucion i veçantë nja Ministri apo dikush tjetër.

Daut Azemi, në këtë rast arsyetimi i ministrisë ka qenë që kërkesa te vij nga titullari kompania "Pastrimi".

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 9 kundër, 3 abstenime aprovoi Vendim

VII

Propozim Vendimi për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të Hyrave vetanake për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozi.

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Herolind Kozhani, tha se ne grupi i PDK-së, e mbështesim këtë propozim vendim.

Armend Grajqevci, tha se ne si grup i LDK-së, e kemi analizuar këtë propozim dhe e përkrahim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, dhe 2 abstenim aprovoi Vendim

VIII

Propozim Vendimi për bartjen e të hyrave vetanake te komunës së Lipjanit të vitit 2021 dhe 2022 në vitin 2023..

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ardit Cani, tha se ne grupi i PDK-së, e përkrahim këtë propozim vendim.

Besiana Sylja, tha se neni 9 i ligjit nuk ta lejon bartjen e të hyrave vetanake, dhe ato nuk kthehen edhe pse nuk po ua sqaron qytetarëve që nuk kthehen ato mjete.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se di qysh po pyet ti ki qef, duhet te gjitha anëtarët e kuvendit me pas qejf qe po ju kthen këto mjete qytetarëve të komunës tonë. Pasi qe këto janë taksa të taksapaguesve tanë.

Besiana Sylja, tha se unë jam për të mirën e qytetarëve dhe punët e mira i vlerësoj, por aty ku e shoh që nuk po punohet mire do te kritikoj dhe do të jepi sugjerimet e mia.

Arsim Jashari, tha se fillimisht Ministria ka marrë vendim ja ka blloku financat krejt komunave, pastaj e bllokoj opozita në Kuvend dhe Ministria prape e ka lejuar.

Fadil Spahiu, ne si grup i anëtarëve te pavarur e përkrahim këtë propozim vendim.

Latif Ramadani, tha se të hyrat e komunës janë vetanake edhe nuk mundet me ja marr askush sipas kushtetutës se Kosovës.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për dhe 2 abstenime, aprovoi Vendimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15:30.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi